



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 121/2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi për ankesën e Qerim Bajrami në cilësinë kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik VAKAT, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë procesit të numërimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur me 02.02.2011, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Qerim Bajrami në cilësinë kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik VAKAT.

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 31.01.2011, nga Qerim Bajrami në cilësinë kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik VAKAT, me të cilën pretendohet se në rezultatet preliminare të datës 12.12.2010, në raportin e komunitetit të tyre kandidati në fjalë ka qenë në avantazh për 670 vota. Po ashtu sipas KQZ-së, në të gjitha kutitë e votimit të hapura dhe të numëruara ka qenë në avantazh. Gjithashtu edhe në raportet nga Dragashi, Vitomirica dhe Mitrovica kanë qenë në favorin e tij. Andaj parashtruesi i ankesës kërkon që të verifikohen dhe të numërohen kutitë tjera të votimit nga komuna e Prizrenit.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- ankesa është e pabazuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës se nga rezultatet preliminare të datës 12.12.2010, si kandidat me nr. 9 ka qenë në avantazh prej 670 vota, të njëjtën gjendje e ka pasur edhe pasi që KQZ-ja i ka rinumëruar votat ku i njëjti potencon se në favorin e tij votat kanë qenë edhe në Dragash, Vitomiricë dhe Mitrovicë. Megjithatë, PZAP vlerëson se për vërtetimin e këtyre pretendimeve i njëjti PZAP-it nuk i ka ofruar asnjë provë të vetme materiale që të mund të vërtetohen si të bazuara pretendimet e tij nga ankesa, andaj në mungesë të provave PZAP-i ankesën si të tillë e refuzon si të pabazuar.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 121/2011 më datën 02.02.2011

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha

